



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 241/7 prot.

Datë 09.02.2026

V E N D I M
Nr. 211/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 09.02.2026, shqyrtoi kërkesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “TIMAK” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-68872-11-13-2025, me objekt: "Blerje makine zjarrefikese e re", me fond limit 29,166,667.00 (njëzet e nëntë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) Lekë pa TVSH. VLERA E FONDIT LIMIT NË EURO: 301,651.33 (treqind e një mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e një .33) Euro pa TVSH, zhvilluar me datë 15-12-2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Andi Hamo” PF në procedurën e prokurimit të mësipërme.

Ankimues:

Operatori ekonomik “TIMAK” SHPK me NIPT L62030020B dhe adresë Tirana Industrial Park , Nr. 37, Rruga Egnatia, Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Vlorë

Sheshi “4 Heronjtë”, Rruga “Osman Haxhiu”

Subjekt i interesuar: Operatori ekonomik “Andi Hamo” PF me NIPT K76926201W dhe adresë Vlorë, Lagjja Kushtrimi, Rruga Transballkanike, Banese private pranë ish Agjensisë së Vjetër

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 14-11-2025 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-68872-11-13-2025, me objekt: "Blerje makine zjarrefikese e re", me fond limit 29,166,667.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 15-12-2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.

II.2. Në datën 15-12-2025, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 14.01.2026, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. TIMAK shpk	23,750,000.00 lekë	skualifikuar
2. VELLEZERIT AGALLIU 20 shpk SHPK	24,500,000.00 lekë	skualifikuar
3. Andi Hamo PF	25,800,000.00 lekë	kualifikuar

II.4. Në datën 21.01.2026, në Sistemin e Prokurimit Elektronik autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftimin e Fituesit Paraprak të procedurës së prokurimit.

II.5. Në datën 26.01.2026 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 241/2026 protokolli, datë 27.01.2026 dhe me numër ankimi elektronik A/2026/6278 e operatorit ekonomik “TIMAK” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-68872-11-13-2025, me objekt: "Blerje makine zjarrefikese e re", me fond limit 29,166,667.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 15-12-2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “TIMAK” SHPK, si dhe me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Andi Hamo” PF.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 241/1 prot., datë 27.01.2026.

II.7. Me shkresën me nr. 1813/2 prot., datë 02.02.2026 me lëndë “Vendim lidhur me ankesën me numër protokolli 241/2026, datë 27.01.2026”, protokolluar me tonën me nr. 241/3 prot., datë 03.02.2026 autoriteti kontraktor Bashkia Vlorë ka dorëzuar nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike aktin e trajtimit të operatorit ekonomik “Timak” SHPK nga ku rezulton se e ka pranuar pjesërisht atë si vijon:

[...] Ne si KSHA pasi u njohëm me ankesën e depozituar nga operatori ekonomik dhe pas shqyrtimit të gjithë dokumentacionit të administruar në dosjen e tenderit për këtë procedurë dhe kriteret veçanta të kualifikimit sipas dokumentacionit përkatës, po ju paraqesim konstatimet lidhur me pretendimet e paraqitura nga operatori ekonomik si më poshtë vijon:

-Në lidhje me pikën 2.3.4 ankesa e operatorit Timak shpk nuk qëndron pasi operatori Andi Hamo e ka paraqitur autorizimin e prodhuesit dhe distributorit të autorizuar me të dhëna të sakta të prodhuesit duke i pasur të pasqyruara adresën dhe numrin e telefonit në mënyrë që AK të kryej verifikimet e posacme.

- Në lidhje me pikën 2.3.5 ky argumentim qëndron pasi operatori ekonomik nuk ka dorëzuar në fazë ofertimi certifikatën e konformitetit europian (certificate of conformity Coc).*

Në përmbyllje vlerësojmë se pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik “Timak” SHPK janë pjesërisht të bazuara, pasi në këtë fazë të procedurës autoriteti kontraktor ka vepruar në përputhje me dispozitat e VKM nr. 285 dhe me kërkesat e dokumentave standarde të tenderit.

Pretendimi i operatorit ekonomik pranohet pjesërisht vetëm për pikën 2.3.5 të ankesës dhe rrëzohet për pikën 2.3.4 të kriteretve të vendosura nga Njësia e Prokurimit.

Konkluzion:

Sa më sipër, referuar të dy pikave të ankesës, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave vendosi pranimin pjesërisht të ankesës, së paraqitur nga operatori ekonomik TIMAK sh.p.k [...].

II.8. Me shkresën me nr. 1813/2 prot., datë 02.02.2026 me lëndë “Vendim lidhur me ankesën me numër protokoll 241/2026, datë 27.01.2026”, protokolluar me tonën me nr. 241/4 prot., datë 04.02.2026 autoriteti kontraktor Bashkia Vlorë ka dorëzuar nëpërmjet shërbimit postar aktin e trajtimit të operatorit ekonomik “Timak” SHPK.

II.9. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e autoritetit kontraktor, u konstatua se janë paraqitur argumente nga subjekti i interesuar “Andi Hamo” PF në përputhje me nenin 113 të ligjit “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Timak” SHPK për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij ekonomike me arsyetimin si vijon: “[...] Skualifikimi i ofertës për mosplotësim të pikës 2.3.4 të DST është qartësisht i pabazuar, pasi bie drejtpërdrejt ndesh me përmbajtjen faktike të autorizimit të paraqitur nga operatori ekonomik. Nga verifikimi i autorizimit të prodhuesit/distributorit, të depozituar nga shoqëria “TIMAK” sh.p.k. në Sistemin e Prokurimit Elektronik, (shih te dhenat e autorizimit) rezulton se dokumenti përmban qartësisht: a) identitetin e subjektit autorizues; b) adresën e plotë të shoqërisë; c) adresën e email-it; d) numrin e telefonit; Me fjale te tjera, të dhëna te nevojshme dhe te mjaftueshme për kryerjen e verifikimeve nga Autoriteti Kontraktor ne perputhje te plote me kërkesat ligjore Pretendimi i KVO-së se autorizimi nuk përmban të dhëna kontakti nuk gjen asnjë mbështetje në përmbajtjen reale të dokumentit dhe përbën konstatim faktik të pasaktë. Sa i përket faktit që në autorizim përmendet edhe shprehja “konvertim në zjarrfikëse”, theksohet se ky element nuk e zhbën autorizimin për ofrimin e automjetit dhe as: i. nuk e kufizon objektin e autorizimit; ii. nuk e ndryshon subjektin autorizues; iii. dhe nuk bie ndesh me kërkesën e parashikuar në DST. Përkundrazi, autorizimi përfshin shprehimisht ofrimin e automjetit objekt prokurimi, ndërsa referimi ndaj konvertimit përbën një shtesë përshkruese, e cila nuk cenon vlefshmërinë juridike dhe funksionale të dokumentit dhe nuk mund të shërbejë si bazë për skualifikim. Në këto kushte, skualifikimi për pikën 2.3.4 nuk qëndron as në aspektin faktik dhe as në atë juridik”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën nr. 8 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.4 “Kapaciteti teknik”, të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë në SPE autorizim prodhuesi dhe distributor i autorizuar, me të dhëna të sakta të prodhuesit. Ky dokument duhet të përmbaj adresë të saktë email dhe numër telefoni të shoqërisë e cila lëshon autorizimin, në mënyrë që AK të kryej verifikimet e posacme.

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik “Timak” SHPK, për përmbushjen të kriterit të mësipërm, rezulton se ky i fundit ka paraqitur dokumentacion si më poshtë vijon:

- Dokumentin me emërtimin “Autorizim Prodhuesi” datë 13.12.2025 lëshuar nga Rafaelo 2002 me përmbajtje si vijon: “Rafaelo 2002 sh.a si importues i Maan Truck & Bus SE – më përfaqësues z. F. B deklaroi se: autorizon Timak SHPK NIPT L62030020B, adresë: Tirana Industrial Park, nr. 37, kashar, Tiranë të ofroj automjetet dhe konvertimin në zjarrfikëse, për modelin Man TGM 18.320 4x4 në tenderin si më poshtë: numër reference: REF-68872-11-13-2025, autoritet kontraktor: Bashkia Vlorë, objekt: “blerje makinë zjarrfikëse e re”, Timak SHPK është shoqëri e regjistruar në Republikën e Shqipërisë, e autorizuar nga shoqëria jonë si përfaqësuese në këtë procedurë për shitjen dhe servis të markës MAN”.
- Dokumentin lëshuar nga Man Truck & Bus SE, datë 17.09.2021 me përmbajtje si vijon: “Për këdo që mund ti përkasë, me këtë konfirmojmë se kompania: Rafaelo 2002 sh.a MAN Truck & Bus Center Tirana Rruga: Industriale autostrada Tiranë-Durrës, km 16 Vorë-Tiranë është importues i MAN Truck & Bus SE për tregun Shqiptar..”

III.1.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; 21 d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik”.

III.1.4. Neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe vepronjë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.1.5. Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim. 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që

bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve.”

III.1.6. Në nenin 92 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme. 2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet. 3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji. Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

III.1.7. Në nenin 40, pika 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se: “Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit,

me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

III.1.8. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këtoparime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/ kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

III.1.9. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, vërejmë se autoriteti kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit ka kërkuar shprehimisht që operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim prodhuesi dhe distributor i autorizuar, me të dhëna të sakta të prodhuesit. Ky dokument duhet të përmbaj adresë të saktë email dhe numër telefoni të shoqërisë e cila lëshon autorizimin, në mënyrë që autoriteti kontraktor të kryej verifikimet e posacme.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik, nga operatori ekonomik ankimues “Timak” SHPK, konstatohet se ky i fundit ka paraqitur ndër të tjera edhe dokumentin, me emërtimin “Autorizim prodhuesi”, datë 13.12.2025 lëshuar nga Rafaelo 2002

me përmbajtje si vijon: “Rafaelo 2002 sh.a si importues i Maan Truck & Bus SE – më përfaqësues z. F. B deklaroi se: autorizon Timak SHPK NIPT L62030020B, adresë: Tirana Industrial Park, nr. 37, kashar, Tiranë të ofroj automjetet dhe konvertimin në zjarrëfikëse, për modelin Man TGM 18.320 4x4 në tenderin si më poshtë: numër reference: REF-68872-11-13-2025, autoritet kontraktor: Bashkia Vlorë, objekt: “blerje makinë zjarrëfikëse e re”, Timak SHPK është shoqëri e regjistruar në Republikën e Shqipërisë, e autorizuar nga shoqëria jonë si përfaqësuese në këtë procedurë për shitjen dhe servis të markës MAN”, si dhe dokumentin lëshuar nga Man Truck & Bus SE, datë 17.09.2021 me përmbajtje si vijon: “Për këdo që mund ti përkasë, me këtë konfirmojmë se kompania: Rafaelo 2002 sh.a MAN Truck & Bus Center Tirana Rruga: Industriale autostrada Tiranë-Durrës, km 16 Vorë-Tiranë është importues i MAN Truck & Bus SE për tregun Shqiptar..”. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar dokumentin me emërtim “Autorizim prodhuesi”, lëshuar nga Rafaelo 2002 më datë 13.12.2025, duke marrë shkas nga arsyeja e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues, konstaton se arsyeja e skualifikimit lidhet me faktin se “Operatori ekonomik ne autorizimin e prodhuesit te paraqitur ka cituar "konvertim ne zjarrfikse". Referuar autorizimit të prodhuesit të dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik “Timak” SHPK Komisioni konstaton, se operatori ekonomik ka dorëzuar autorizim nga prodhuesi konkretisht për automjete dhe konvertim në zjarrëfikëse, ku pasqyrohen kompania prodhuese dhe të dhënat e identifikimit të tyre, duke dhënë një indicie që e përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit. Në rast se autoriteti kontraktor kishte dyshime lidhur me autorizimin e dorëzuar apo mjetin objekt i këtij autoizimi mund ti kërkonte sqarime operatorit ekonomik në mbështetje të nenit 92 të LPP-së. Pra, operatori ekonomik “Timak” SHPK me dokumentacion e paraqitur përmbush kërkesën e përcaktuar në pikën 2.3.4 të “Kritereve të Veçanta të Kualifikimit”, të dokumenteve të tenderit.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Timak” SHPK për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij ekonomike me arsyetimin si vijon: “Skualifikimi për mosplotësim të pikës 2.3.5 të DST buron nga një keqlexim i qartë i vetë kriterit, ashtu siç është formuluar nga Autoriteti Kontraktor. Teksti i kriterit parashikon se: “?...Automjeti që ofrohet duhet të jetë i pajisur me Certifikatë të Konformitetit European (COC)” Nga ky formulim rezulton qartësisht se kriteri nuk kërkon paraqitjen e Certifikatës COC si dokument në fazën e ofertimit, por përcakton një karakteristikë teknike të automjetit që do të dorëzohet në zbatim të kontratës. Kriteri sipas pikës 2.3.5: a) nuk përdor formulime të tilla si “duhet të paraqesë”, “duhet të depozitohet” apo “duhet të ngarkohet në SPE”; b) nuk e trajton COC-në si dokument kualifikimi në këtë fazë; c) i referohet cilësisë së mallit që do të ofrohet dhe dorëzohet në të ardhmen. Pra, bëhet fjalë për automjetin zjarrfikës që do të prodhohet ose blihet pas lidhjes së kontratës dhe do të dorëzohet në përputhje me kërkesat teknike, dhe jo për një automjet ekzistues në momentin e ofertimit. Interpretimi i ndjekur nga KVO do të çonte në një përfundim jo logjik dhe jorealit, sipas të cilit Autoriteti Kontraktor do të kishte kërkuar automjete: a) tashmë të prodhuara; b) të identifikuar individualisht; c) të pajisura paraprakisht me Certifikatë COC; d) dhe faktikisht të gatshme për dorëzim që në fazën e ofertimit. Një kërkesë e tillë nuk është e shprehur në DST, nuk përputhet me natyrën juridike të Certifikatës COC, e cila lëshohet në momentin e marrjes dhe dorëzimit të mjetit dhe nuk përputhet me logjikën e një procedure prokurimi për

furnizim mallrash. Për rrjedhojë, skualifikimi për këtë arsye nuk buron nga mosplotësimi i kriterit, por nga një interpretim i gabuar literal, që i atribuon kriterit një detyrim dokumentar që nuk rezulton i parashikuar”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në shtojcën nr. 8 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.5 “Kapaciteti teknik”, të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2.3.5 Automjeti që ofrohet duhet të jetë i pajisur me Certifikatë të Konformitetit European (Certificate of Conformity – COC), të lëshuar nga prodhuesi në përputhje me direktivat dhe standardet e Bashkimit European për automjetet rrugore.
Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë autorizimin e prodhuesit/distributorit.

III.2.2. Në procesverbalin “PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM” autoriteti kontraktor ka përcaktuar si vijon:

2.3.5 Automjeti që ofrohet duhet të jetë i pajisur me Certifikatë të Konformitetit European (Certificate of Conformity – COC), të lëshuar nga prodhuesi në përputhje me direktivat dhe standardet e Bashkimit European për automjetet rrugore.
Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë autorizimin e prodhuesit/distributorit.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kërkesa që automjeti zjarrfikës të jetë i pajisur me Certifikatë të Konformitetit European (Certificate of Conformity – COC) është një element thelbësor për garantimin e cilësisë, sigurisë dhe përputhshmërisë teknike të mjetit me standardet ndërkombëtare. COC është një dokument zyrtar i lëshuar nga prodhuesi i automjetit, i cili vërteton se mjeti përmbush të gjitha kërkesat teknike dhe mjedisore të përcaktuara në direktivat e Bashkimit European për automjetet rrugore.

III.2.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik “Timak” SHPK, për përmbushjen të kriterit të mësipërm, rezulton se ky i fundit ka paraqitur dokumentacion si më poshtë vijon:

- Dokumentin “Deklaratë për origjinën e mjeteve”, datë 15.12.2025 me përmbajtje si vijon: “Në përmbushje të kriterëve të DST dhe në kuadër të procedurës së prokurimit që do të zhvillohet më datë 15.12.2025 nga operatori kontraktor Bashkia Vlorë, me objekt: “Blerje makine zjarrfikëse e re”, me fond limit 29,166,667. 00 lekë pa TVSH, operatori ekonomik Timak sh.p.k, me NUIS L62030020B, përfaqësuar nga administrator znj. M. K, deklaron: se automjetet MAN TGM 18.320 Dopio Kabine 4x4, të ofruara në kuadër të kësaj procedure, janë të prodhuara në vendet e Bashkimit

Europian dhe janë të destinuara për tregun e BE-së, duke përmbushur standardet, normat teknike dhe legjislacionin përkatës të zbatueshëm për këtë kategori mjetesesh.

- Automjeti i ofruar do të jetë i pajisur me certifikatë të konformitetit European (Certificate of Conformity-CoC), të lëshuar nga prodhuesi përkatës, në përputhje të plotë me direktivat dhe standardet e Bashkimit European për automjetet Rrugore.
- Certifikata e Konformitetit do ti vihet në dispozicion Autoritetit kontraktor në momentin e dorëzimit dhe regjistrimit të automjetit.
- Certifikata e Konformitetit (CoC) është një dokument unik për çdo shasi dhe lëshohet vetëm nga prodhuesi zyrtar. Ky dokument merret zyrtarisht vetëm në momentin e blerjes dhe regjistrimit të automjetit, ndaj është e natyrshme që CoC të mos jetë i disponueshëm në fazën e ofertimit. Bashkëngjitur kësaj deklarate paraqitet një model ilustrues i një Certifikatë Konformiteti, i cili shërben vetëm si shembull dhe jo si dokument zyrtar i mjeteve që do të dorëzohen. ...”

III.2.4. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: “Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.2.5. Neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.2.6. Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në

një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Xhironja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.2.7. Në nenin 92 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme. 2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet. 3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

III.2.8. Në nenin 40, pika 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se: “6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuara, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

III.2.9. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues

marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/ kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, hartimi i dokumenteve të tenderit dhe zhvillimi i procedurës së prokurimit është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejte me kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit dhe hapat që duhet të ndiqen për përzgjedhjen e ofertës më të mirë, në kuptim të këtij ligji.

III.2.10. Referuar arsyes së skualifikimi të operatorit ekonomik ankimues “Timak” SHPK me arsyetimin se: *“Operatori ekonomik nuk përmbush piken 2.3.5 të DST 2.3.5 Automjeti që ofrohet duhet të jetë i pajisur me Certifikatë të Konformitetit European (Certificate of Conformity – COC), të lëshuar nga prodhuesi në përputhje me direktivat dhe standardet e Bashkimit European për automjetet rrugore. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë autorizimin e prodhuesit/distributorit. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur certifikatë konformiteti.”*, si dhe nga verifikimi i dokumenteve të tenderit Komisioni konstaton, se në pikën 2.3.5 të shtojcës 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, autoriteti kontraktor ka kërkuar si vijon: *”2.3.5 Automjeti që ofrohet duhet të jetë i pajisur me Certifikatë të Konformitetit European (Certificate of Conformity – COC), të lëshuar nga prodhuesi në përputhje me direktivat dhe standardet e Bashkimit European për automjetet rrugore.*

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë autorizimin e prodhuesit/distributorit”. Referuar dokumentacionit të ngarkuar në SPE nga operatori ekonomik ankimues rezulton se operatori ekonomik ka ofertuar mjetin Kamion i ri Zjarrfikës 5000lt, dhe në përmbushje të kriterit të veçantë të kualifikimit, pikës 2.3.5 ka ngarkuar në SPE dokumentin “Deklaratë për origjininën e mjeteve”, datë 15.12.2025 ku ka deklaruar se: *“[...] se automjetet MAN TGM 18.320 Dopio Kabine 4x4, të ofruara në kuadër të kësaj procedure, janë të prodhuara në vendet e Bashkimit European dhe janë të destinuara për tregun e BE-së, duke përmbushur standardet, normat teknike dhe legjislacionin përkatës të zbatueshëm për këtë kategori mjetesh. Automjeti i ofruar do të jetë i pajisur me certifikatë të konformitetit European (Certificate of Conformity-CoC), të lëshuar nga prodhuesi përkatës, në përputhje të plotë me direktivat dhe standardet e Bashkimit European për automjetet Rrugore. Certifikata e Konformitetit do të vihet në dispozicion Autoritetit kontraktor në momentin e dorëzimit dhe regjistrimit të automjetit. Certifikata e Konformitetit (CoC) është një dokument unik për çdo shasi dhe lëshohet vetëm nga prodhuesi zyrtar. Ky dokument merret zyrtarisht vetëm në momentin e blerjes dhe regjistrimit të automjetit, ndaj është e natyrshme që CoC të mos jetë i disponueshëm në fazën e ofertimit. Bashkëngjitur kësaj deklarate paraqitet një model ilustrues i një Certifikatë Konformiteti, i cili shërben vetëm si shembull dhe jo si dokument zyrtar i mjeteve që do të dorëzohen. ...”.* Referuar deklaratës së dorëzuar, si dhe nga verifikimi i dokumentacionit të ngarkuar në SPE, Komisioni konstaton, se operatori ekonomik “Timak” SHPK në përmbushje të kriterit të veçantë të kualifikimit, pikës 2.3.5 të “Kriterëve të veçanta të kualifikimit”, nuk

ka dorëzuar certifikatë COC për mjetin e ofertuar, por ka dorëzuar vetëm “Deklaratë për origjinën e mjetit”, me anë të së cilës deklarohet se automjeti do të jetë i pajisur me certifikatë të Konformitetit Europian (certifikatë of Conformity-COC) të lëshuar nga prodhuesi. Akoma më tej edhe vetë operatori ekonomik ankimues në deklaratën e dorëzuar, si dhe në ankesën me nr. 241 prot., datë 27.01.2026 e pranon që nuk ka dorëzuar certifikatë konformiteti (CoC) duke deklaruar se kjo certifikatë merret vetëm në momentin e blerjes dhe regjistrimit të automjetit, ndaj nuk është e disponueshme në fazën e ofertimit. Referuar kriterit të veçantë të kualifikimit të sipërpërmendur pikës 2.3.5 të shtojcës nr. 8, autoriteti kontraktor ka kërkuar që automjeti që ofrohet duhet të jetë i pajisur me certifikatë CoC. Me anë të këtij kriteri autoriteti kontraktor krijon sigurinë për garantimin e cilësisë, sigurisë dhe përputhshmërisë teknike të mjetit me standardet ndërkombëtare, si dhe se mjeti përmbush të gjitha kërkesat teknike dhe mjedisore të përcaktuara në direktivat e Bashkimit Europian për automjetet rrugore. Ky kriter i shërben autoriteti kontraktor për të garantuar realizimin me sukses të kontratës nga operatori ekonomik fitues. Referuar dokumentacionit të administruar në fashikullin administrativ Komisioni gjykon, se deklarata e lëshuar nga ofertuesi nuk e zëvendëson Certifikatën e Konformitetit (CoC) e cila lëshohet nga prodhuesi për automjetin konkret dhe është unik për çdo automjet, për çdo shasi.

Akoma më tej Komisioni thekson, se nëse operatori ekonomik ankimues kishte paqartësi në lidhje me përmbushjen e kriterit të veçantë të kualifikimit ka patur në dispozicion momentin procedural për të kërkuar sqarime bazuar në nenin 75 të LPP-së apo momentin procedural për kundërshtimin e dokumenteve të tenderit bazuar në nenin 110 të LPP-së.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.3. Lidhur me vendimin e KSHA së autoritetit kontraktor për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Timak” SHPK, nga ku evidentohet se KSHA nuk ka marrë në shqyrtim pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Timak” SHPK për kundërshtimin e vendimit të KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij ekonomike, por ka marrë në shqyrtim vetëm pretendimet e ngritura për kundërshtimin e vendimit të KVO-së për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Andi Hamo” PF, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor lidhur me këtë vendimmarrje nuk ka vepruar në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për prokurimin publik. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimimit etj., përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga LPP, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementeve të mësipërme lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike. Në interpretim sistematik (domethënie e drejtë të normës juridike duke e vënë në lidhmëri me normat e tjera brenda sistemit juridik), Komisioni i Prokurimit gjykon, se ligjvënësi ka ndarë qartësisht dy momentet procedurale, atë të vlerësimit të ofertave nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe momentin e dytë të garancisë procedurale të mbrojtjes së interesave të ligjshme të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, atë të ankimit administrativ pranë

autoritetit kontraktor (rishikimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave) nga vetë autoriteti kontraktor por nga një trupë e re, e cila nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesave me komisionin e vlerësimit të ofertave, shqyrtimin e ankesave nga K.Sh.A (Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave). Normativa e parashikuar nga legjislacioni i prokurimit publik mbi afatet e ankimit administrativ rregullon të drejtën e personave të interesuar në një procedurë prokurimi për të paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik në kuadrin e rishikimit administrativ të kësaj procedure, e thënë ndryshe, legjitimitimin për të vënë në lëvizje dhe investimin e autoritetit kontraktor për rishikimin e vendimit të KVO-së. Procedura përpara autoritetit kontraktor si edhe para KPP, ka natyrën e procedurave të nxitura, pasi autoriteti kontraktor nuk mund të bëhet vetëiniciator i fillimit të procedurave kryesisht. Si rregull, investimi i K.Sh.A është i bazuar (faktikisht i kufizuar) nga ankimet e sjella pranë saj vetëm nga subjekte të legjitimuara dhe që plotësojnë kushtet formale të ankesës, ku një prej të cilave është dhe respektimi i afateve të ankimit. Pra, komisioni i shqyrtimit të ankesave në asnjë rast nuk duhet të marrë në shqyrtim një ankesë e cila është paraqitur në mungesë të kushteve formale, legjitimitimit të operatorit ekonomik ankimues për kundërshtimin e kualifikimit të operatorit ekonomik “Andi Hamo” PF, duke ngritur pretendime për një operator ekonomik të renditur me një ofertë ekonomike më të lartë se operatori ekonomik ankimues, e duke nxjerrë në këtë mënyrë një akt në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin publik dhe referuar ligjit Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ky akt është absolutisht i pavlefshëm dhe nuk prodhon asnjë pasojë ligjore. Për këtë arsye, Komisioni gjykon, se vendimi i KSHA për shqyrtimin e pretendimeve të ngritura në ankesës nga operatori ekonomik “Timak” SHPK lidhur me kundërshtimin e kualifikimit të operatorit ekonomik “Andi Hamo” PF është në kundërshtim të plotë me aktet në fuqi, ndaj do të shpallet absolutisht i pavlefshëm nga Komisioni i Prokurimit Publik.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatorit ekonomik “Timak” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-68872-11-13-2025, me objekt: "Blerje makine zjarrefikese e re", me fond limit 29,166,667.00 (njëzet e nëntë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e

gjashtëdhjetë e shtatë) Lekë pa TVSH. VLERA E FONDIT LIMIT NË EURO: 301,651.33 (treqind e një mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e një .33) Euro pa TVSH, zhvilluar me datë 15-12-2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.

2. Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësimin e procedurës së prokurimit sipas konstatimeve të Komisionit të Prokurimit Publik.
 3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës që të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Timak” Shpk.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

